**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**VU644 – 18 – 7497 – 1-2-1/C135**
**14 Nr. 1170/18**
**Dt. 22.11.2018**

# KONTRATË FURNIZIMI

**Palët kontraktuese:**

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Saranda Cakaj** – Drejtoreshë për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejmë **Porositësi)** , dhe

2. **NPSH " Oni Design "** me seli në **Prishtinë,** me NRB : **70532735 e Nr.F: 600312574**, të cilën e përfaqëson **z. Ilir Sadiku**, në tekstin e mëtejmë: **Furnizuesi**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontrate publike kornizë, për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon:

**Furnizimi me pajisje për përkrahje të bizneseve sipas Lot. 1 deri Lot.4** , me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prokurimi Nr. | VU644 | 1 | 8 | 74 | 9 | 7 | 1 | 2 | 1 |
| Prokurimi Nr. | 644 | 1 | 8 | 1 | 8 | 2 | 1 | 2 | 1 |

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Furnizimi me pajisje për përkrahje të bizneseve sipas Lot. 1 deri Lot.4**

**Lot. 3: Furnizimi me pajisje për shërbime hoteliere**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-18-182-121.**

**Neni 2 Kushtet e dërgesës**

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: **30 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.**

2.2 Vendi i dorëzim-pranimit të pajisjeve do të jetë: **përfaqësuesit e bizneseve, përfitues të përkrahjes së bizneseve, të përzgjedhur nga Njësia e Kërkesës e Autoritetit Kontraktues.**

2.3 Furnizuesi merr për obligim dhe pajtohet që pajisjet, sipas përshkrimit teknik dhe Specifikacionit Teknik ti dërgoi te Autoriteti Kontraktues në Vushtrri. **Një herit Furnizuesi merr për obligim që përfituesit e pajisjeve sipas nevojës t'u ofroi shërbime të aftësimit dhe informimit të mjaftueshme lidhur me mënyrën e përdorimit dhe funksionimin e pajisjes së dorëzuar.**

2.4 **Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së pajisjeve** do të bëhet nga Komisionit të Pranimit të Mallit, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia e furnizimeve, nga ana e Komisionit të Pranimit të Mallit.

2.5 Në rast se Shitësi dështon në përmbushjen me kohë të detyrimit si në paragrafin paraprak të këtij neni, Blerësi mbanë të drejtën që për secilën ditë në vonesë të Shitësit, të zbatoi penale me 0,25% të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës, në çdo ditë të vonesës.

2.6 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP[1] (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

2.7 Garancioni **për cilësinë e pajisjeve** do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Afati i garancionit fillon nga data e pranim – dorëzimit të pajisjeve, dhe përfundon në një afat prej minimum 12 muaj.

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i furnizimeve të pajisjeve sipas **Lot. 3 është** në shumë prej: **15.048,70€( pesëmbëdhjetmijedyzetetetë/70€ ).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do ti nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës, respektivisht pas Pranimit të pajisjeve nga ana e Komisionit për Pranim të Mallit të Autoritetit Kontraktues.

**Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

(d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

(f) Plani për menaxhimin e kontratës;

(g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës se vendit

(h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 5 Komunikimet**

---

[17] DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[2] në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues:**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | Saranda Cakaj |
| **Pozita:** | Drejtoreshë për Prokurim Publik |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 22.11.2018 |
| **Vula:** | |

**Për Kontraktuesin - Furnizuesin:**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | Ilir Sadiku |
| **Pozita:** | Përfaqësues i NPSH " Oni Design" |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 22.11.2018 |
| **Vula:** | |

[2] Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

**LOT3 Furnizimi me pajisje për shërbime hoteliere**

**Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G**
**Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 18, apo 8, e jo në formatin ~~18% apo 8%,~~ Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, çmidin duhet ta shkruani me dy decimale pas presjes dhjetore**

| *Nr.* | *Përshkrimi i pozicioneve* | *Njësia Matëse* | *Sasia* | *Çmimi për njësi pa TVSH* | *Norma e TVSH-së në %* | *Çmimi për njësi (me TVSh)-€* | *Totali (Pa TVSH)* | *TVSH* | *Totali (me TVSH)-€* | *Shënim i operatorit ekonomik* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | TV ultra HD 65uk6470plc , | Copë | 1 | 761.86 | **18.00** | **899.00** | 761.86 | 137.14 | **899.00** | |
| 2 | Inventar tavolina luksoze 8copa (90x90) me 4 ulëse Dimensionet 45x45x90 per lokale me shtof | Komplet | 8 | 127.12 | **18.00** | **150.00** | 1,016.95 | 183.05 | **1,200.00** | |
| 3 | Shtrydhëse portokalli /shtrydhëse frutash/ limon AK/5 portokalli Motor i heshtur ;1/6hp – kundër ujit Ene nga qeliku ;18\10 1/6hp/ 220-30V Fuqia 1200rpm | Copë | 4 | 147.84 | **18.00** | **174.45** | 591.36 | 106.44 | **697.80** | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Makinë për akull 46kg/24, kap i kabinës 25kg<br>Prodhimi ne 24 ore 47 kg<br>Kapaciteti 25 kg<br>Sistemi i ftohjes A-W<br>Llojet e kubit A -18 gram c- 33 g,D-13g,e-42gram<br>Frigoriferi R404A<br>Tensioni standart 220-240V-50HZ<br>Konsumi elektrik 500W<br>Siguresa, fuza 10 A<br>Konsumi i ujit A;4 Litra /kg ,w;14 litra /kgMadhësia 500-580-800<br>Pesha neto 56 kg<br>Pesha bruto 64kg Temperatura e ambientit ;+10° C / +50° F min +43° C / 110° F max.<br>Temperatura e ujit; +3° C / +37° F min +32° C / +90° F max<br>Tension; -10% min +10% max<br>Presioni i ujit; 1bar (14 psi)min 6bar (84 psi)max | Copë | 1 | 1107.63 | **18.00** | **1,307.00** | 1,107.63 | 199.37 | **1,307.00** | |
| 5 | Prerëse perimesh 250 pa disqe2000rn la romangola 3000N-2500 230W -50hz 155x75 (mm) Pesha neto 22 kg<br>Pesha bruto 24 kg<br>620x300x580h(m) 0.108m³ | Copë | 1 | 455.08 | **18.00** | **537.00** | 455.08 | 81.92 | **537.00** | |

**LOT3 Furnizimi me pajisje për shërbime hoteliere**

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Disk Z4 Modeli 4000 l<br>Madhsia e diskut 20.5cm<br>Trashësia 1.7cm<br>Madhsia e blurjes 4mm | Copë | 1 | 33.22 | **18.00** | **39.20** | 33.22 | 5.98 | **39.20** | |
| 7 | Prerëse për pershut 25cm<br>Modeli ;25 gs Diametri ;250mm<br>Fuqia ;140w Kapaciteti<br>;230x185mm Pesha neto ;14 kg<br>Paketimi ;48x53x39cm A<br>;415MM B;263mm C;365mm<br>D;480mm E363mm | Copë | 1 | 305.08 | **18.00** | **360.00** | 305.08 | 54.92 | **360.00** | |
| 8 | Lavaman 1grop dimensioni<br>165x70x90 inox 304 | Copë | 1 | 350.85 | **18.00** | **414.00** | 350.85 | 63.15 | **414.00** | |
| 9 | Makine elektrike për palpete<br>40cm Kodi ;2178 Modeli ;2<br>pllaka Diametri ;40cmx2<br>Dimensioni 87x54x19 Pesha<br>;22kg Fuqia ;5000w | Copë | 1 | 189.83 | **18.00** | **224.00** | 189.83 | 34.17 | **224.00** | |
| 10 | Fringo tavolin per pije<br>dimensioni 220x70x90 Inox 304 | Copë | 1 | 949.15 | **18.00** | **1,120.00** | 949.15 | 170.85 | **1,120.00** | |
| 11 | Blender 908 Fuqia 400 V<br>Gjersia 8.08inq 120 volt<br>Material metal<br>Gjatësia 6.94inq Lartsia<br>16.29inq | Copë | 1 | 137.29 | **18.00** | **162.00** | 137.29 | 24.71 | **162.00** | |
| 12 | Tavolin frigoriferike me 2 dyer<br>me xhama | Copë | 1 | 901.69 | **18.00** | **1,064.00** | 901.69 | 162.31 | **1,064.00** | |

**LOT3 Furnizimi me pajisje për shërbime hoteliere**

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Mikser planetar 20lit, 3 shpejtësi mekanike Kapaciteti i brumit 2 deri ne 4 kg Kapaciteti i enës 20 l ,Fuqia 1.1kw, 220 V , Shpejtesia 68/170/350epm | Copë | 1 | 664.41 | **18.00** | **784.00** | 664.41 | 119.59 | **784.00** | |
| 14 | Tavoline pune inox me nje raft dhe mbështetje. Tavolin pune 1.80x0.80cm | Copë | 1 | 246.78 | **18.00** | **291.20** | 246.78 | 44.42 | **291.20** | |
| 15 | Tepsi pizza 50cmw | Copë | 5 | 12.86 | **18.00** | **15.18** | 64.32 | 11.58 | **75.90** | |
| 16 | Furre pizza ALFA 4+4, me dinensione 66x66x14cm, 9.4 Kw | Copë | 1 | 759.32 | **18.00** | **896.00** | 759.32 | 136.68 | **896.00** | |
| 17 | Furre per pjekurina Cimav forn 62x62i 5kw elektrike | Copë | 1 | 522.03 | **18.00** | **616.00** | 522.03 | 93.97 | **616.00** | |
| 18 | Mikser per perzirjen e brumit DGD | Copë | 1 | 432.20 | **18.00** | **510.00** | 432.20 | 77.80 | **510.00** | |
| 19 | Karrike druri dhe skaji Dimensonet 95x42x42 | Copë | 90 | 21.19 | **18.00** | **25.00** | 1,906.78 | 343.22 | **2,250.00** | |
| 20 | Furre me 4 tepsia me dimension; 60x40cm Fuqia 3.4kw,230V,50/60hz | Copë | 1 | 854.24 | **18.00** | **1,008.00** | 854.24 | 153.76 | **1,008.00** | |

**LOT3 Furnizimi me pajisje për shërbime hoteliere**

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | Maxima plantary mixer mp m7 pink Pesha neto: 17 kg Përmasat: H425 x W240 x D425 mm 230V / 50Hz / 1Phase 350 Watt Përzierësi i fuqishëm planetarë Enë prej çeliku të fortë prej 7.0L 11 shpejtësi të ndryshme: 100 - 938 rpm | Copë | 1 | 379.66 | **18.00** | **448.00** | 379.66 | 68.34 | **448.00** | |
| 22 | Lesanto sewer rondo furr për flia | Copë | 1 | 123.39 | **18.00** | **145.60** | 123.39 | 22.21 | **145.60** | |
| | **TOTALI I PËRGJITHSHEM ME TVSH:** | | | | | | **12,753.14** | **2,295.56** | **15,048.70** | |

| **IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)** | |
|---|---|
| **EMRI I OE:** | N.P.SH "ONI Design" |
| **EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:** | Ilir Sadiku |
| **NËNSHKRIMI:** | |
| **DATA:** | 29.10.2018 |
| **VULA:** | NDËRMARRJA PRIVATE SHËRBIMESH ONI DESIGN PRISHTINË |